



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L-101**

**PËR PERFORMANCËN ENERGETIKE NË NDËRTESA**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR PERFORMANCËN ENERGETIKE NË NDËRTESA**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Ky Ligj ka për qëllim të promovojë përmirësimin e performancës energjetike në ndërtesa, duke marrë parasysh kushtet e jashtme dhe lokale klimatike, si dhe kërkesat për klimën e brendshme dhe koston efektive.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën nr.2010/31 të BE-së për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe Direktivën 2012/27/të BE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për efikasitetin e energjisë.

## **Neni 2 Fushëveprimi**

### 1. Ky Ligj përcakton kërkesat për:

- 1.1. kornizën e përgjithshme për metodologjinë kombëtare për llogaritjen e performancës së integruar energjetike të ndërtesave dhe njësive të tyre;
- 1.2. kërkesat minimale për performancën energjetike për:
  - 1.2.1. ndërtimin e ndërtesave të reja;
  - 1.2.2. ndërtesat ekzistuese dhe njësive të tyre që i nënshtrohen rinovimeve të mëdha.
- 1.3. kërkesat e përgjithshme për sistemet teknike në ndërtesat ekzistuese;
- 1.4. planet kombëtare për rritjen e numrit të ndërtesave me konsum afërsisht zero-energji duke përfshirë shqyrtimin e stimuljeve financiarë dhe barrierave të tregut për të nxitur kalimin tek ndërtesat me konsum afërsisht zero-energji;
- 1.5. certifikimin energjetik të ndërtesave dhe njësive të ndërtesave dhe përmbajtja, lëshimi dhe ekspozimin e certifikatës;
- 1.6. inspektimi i rregullt i sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit duke përfshirë formën dhe përmbajtjen e raporteve të inspektimit apo masave alternative me efektivitet të njëjtë;
- 1.7. licencimi i ekspertëve të pavarur dhe krijimi i një sistemi të pavarur kontrolli për certifikatat e performancës energjetike të ndërtesave;
- 1.8. krijimi i një sistemi të raportimit për raportet e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit.

## **Neni 3 Përkufizimet**

### 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **Ndërtesa** – një konstruksion i mbuluar dhe me mure, për të cilin përdoret energjia për të arritur kushtet e brendshme klimatike;
- 1.2. **Performanca energjetike e ndërtesës** – sasia e llogaritur e energjisë për të përmbushur kërkesat energjetike lidhur me përdorimin e zakonshëm të ndërtesës, e cila ndër të tjera përfshinë energjinë e përdorur për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë sanitar dhe ndriçim;

1.3. **Certifikimi energjetik i ndërtesave** –procesi për vlerësimin e performances energjetike dhe lëshimin e certifikatës se efijencies se energjisë për një ndërtesë ose pjesë të saj që projektohet, ndërtohet ose rinovohet;

1.4. **Elementet e ndërtesës** –sistemi teknik i ndërtesës dhe mbështjellësi i ndërtesës;

1.5. **Sistemi teknik i ndërtesës**– Sistemet teknike për ngrohje, ftohje, ventilim, ujë të ngrohtë, ndriçim apo kombinime të tyre, të një ndërtese apo njësie të ndërtesës;

1.6. **Mbështjellësi i ndërtesës**–elementet e integruara të një ndërtese të cilat ndajnë brendësinë e saj nga ambienti i jashtëm;

1.7. **Sistem i kondicionimit të ajrit** –për nevoja të këtij Ligji paraqet kombinimin e komponenteve të nevojshme për të ofruar trajtimin dhe rregullimin e temperaturës së ajrit të brendshëm;

1.8. **Sistem i ngrohjes** – kombinimi i komponentëve të nevojshme për të ofruar një formë të trajtimit të ajrit të brendshëm, përmes të cilit bëhet rregullimi i temperaturës;

1.9. **Sistem ventilimi** - kombinimi i komponentëve të nevojshme për të ofruar një formë të trajtimit të ajrit të brendshëm, me të cilin rregullohet rrymimi i ajrit;

1.10. **Auditor i Energjisë** - personi fizik apo juridik i licencuar për auditim energjetik sipas Ligjit për Efijencën e Energjisë;

1.11. **Ekspert i pavarur** –auditori i energjisë apo person tjetër i cili është i licencuar që të bëjë certifikimin energjetik dhe/ose të inspektojë sistemet e ngrohjes dhe/ose të kondicionimit të ajrit në ndërtesa;

1.12. **Ndërtesë me konsum afër zero-energji** –ndërtesa që ka performancë shumë të lartë energjetike, e cila përcaktohet në pajtim me Nenin 5 të këtij ligji. Konsumi afër zero-energji apo një sasi shumë e vogël e energjisë së nevojshme të mbulohet në masë të madhe nga energjia e prodhuar nga burimet e ripërtritëshme në lokacion apo diku afër;

1.13. **Certifikata e Performancës Energjetike (CPE)** – certifikatë e njohur nga autoritetet kompetente kombëtare apo nga një person juridik i autorizuar prej tyre, që tregon performancën energjetike të një ndërtese apo të një njësie të ndërtesës;

1.14. **Inspektimi i sistemeve të ngrohjes apo kondicionimit të ajrit** – inspektimi i sistemit të ngrohjes apo kondicionimit të ajrit që kryhet në intervale të rregullta përmes një procedure të njohur nga një ekspert i pavarur për të përcaktuar gjendjen e sistemit dhe të përgatis një raport që dallon nga auditimi energjetik që kërkohet sipas Ligjit për Efijencën e Energjisë;

1.15. **Raporti i inspektimit të sistemeve të ngrohjes apo kondicionimit të ajrit**–raporti i përgatitur si rezultat i inspektimit të sistemit të ngrohjes apo të kondicionimit të ajrit, që e vlerëson gjendjen ekzistuese dhe rekomandon përmirësime me kosto efektive për performancën energjetike të sistemit;

1.16. **Masa alternative** – masa të politikave që mund të miratohen nga qeveria si një alternativë e inspektimeve dhe që kanë ndikim ekuivalent apo me të madh në kursimin e energjisë;

1.17. **Energji nga burime të ripërtitëshme**—energji nga burimet jo fosile siç janë era, uji, gjeotermale, solare, valëve të detit, biomasës, impiantet për trajtimin e mbeturinave dhe ujërave të zeza, si dhe biogazit;

1.18. **Energji primare**— energji nga burime të ripërtitëshme dhe jo të ripërtitëshme e cila nuk i është nënshtruar ndonjë procesi shndërrimi apo transformimi të energjisë;

1.19. **Njësi e ndërtesës** – një seksion, kat apo njësi e banimit brenda ndërtesës që është projektuar apo adaptuar që të përdoret si e veçantë;

1.20. **Rinovim i madh** – rinovimi i një ndërtese ku më shumë se 25% e sipërfaqes së mbështjellësit të ndërtesës i nënshtrohet renovimit;

1.21. **Standard Evropian** –standard i miratuar nga njëra nga organizatat Evropiane për Standardizim që më pas është miratuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit dhe është vënë në dispozicion për përdorim publik;

1.22. **Nivel i kostos optimale** – niveli i performancës energjetike i cili çon në koston më të ulët gjatë vlerësimit të ciklit të jetëgjatësisë ekonomike;

1.23. **Sistem inteligjent i matjes** – një sistem elektronik që mund të masë konsumin e energjisë, duke ofruar më shumë informacion se matësi konvencional dhe që mund të transmetojë dhe pranojë të dhëna duke përdorur një formë të komunikimit elektronik;

1.24. **Metodologjia Kombëtare e Kalkulimit (MKK)** – metodologjia për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të një ndërtese. Përdoret në kalkulimin e niveleve të kostos optimale për kërkesat e performancës energjetike të ndërtesave, njësisive të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave dhe mund të përdoret gjithashtu për të mbështetur nxjerrjen e Certifikatave të Performancës Energjetike (CPE-ve);

1.25. **Organi për lëshimin e certifikatave të energjisë për ndërtesa** – autoriteti apo organi të cilit autoritetet kompetente ia kanë deleguar përgjegjësinë për zbatimin e sistemit të kontrollit të pavarur dhe lëshimin e CPE-ve;

1.26. **Softueri i aprovuar** – softueri i cili zbaton MKK-në dhe është miratuar nga autoritetet kompetente për përdorim në kalkulimin e kërkesave të performancës energjetike të ndërtesave, njësisive të ndërtesave dhe për nxjerrjen e CPE-ve;

1.27. **Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë (AKEE)** –agjencia përgjegjëse për efiçencën e energjisë e themeluar sipas Ligjit për Efiçencën e Energjisë si institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Zhvillim Ekonomik. Ajo është përgjegjëse për sistemet e pavarura të kontrollit për Certifikatat e Performancës Energjetike, raportet inspektuese dhe regjistrin kombëtar.

## **Neni 4 Përfundim**

1. Nenet 6, 7, 9 dhe 10 të këtij ligji nuk zbatohen për:

1.1. ndërtesat e mbrojtura zyrtarisht si pjesë e një mjedisi të caktuar ose për shkak të vlerave të tyre të veçanta arkitektonike apo historike, për aq sa pajtueshmëria me kërkesat minimale për performancë energjetike do të ndryshonin në mënyrë të papranueshme karakterin dhe dukjen e tyre;

1.2. ndërtesat e përdorura si vende të lutjes dhe për aktivitete religjioze;

1.3. ndërtesat e përkohshme me kohë të përdorimit prej dy(2) apo më pak vite, vendet industriale, punëtoritë dhe ndërtesat bujqësore jo-rezidenciale me kërkesë të ulët energjetike dhe ndërtesat bujqësore jo-rezidenciale të cilat janë në shfrytëzim nga një sektor i mbështetur nga një marrëveshje sektoriale kombëtare për performancën energjetike;

1.4. ndërtesat rezidenciale të cilat përdoren apo janë të destinuara për t'u përdorur për më pak se katër(4) muaj të vitit ose, në mënyrë alternative, për një periudhë të kufizuar brenda vitit me konsum të pritshëm të energjisë prej më pak se 25% të asaj që do të ishte rezultat i përdorimit gjatë gjithë vitit;

1.5. ndërtesat individuale me sipërfaqe të përgjithshme të përdorshme prej më pak se 50 m<sup>2</sup>.

## **KAPITULLI II METODOLOGJIA E KALKULIMIT, KËRKESAT PËR PERFORMANCË ENERGJETIKE, SISTEMET ALTERNATIVE ME EFIÇIENCË TË LARTË**

### **Neni 5**

#### **Metodologjia kombëtare për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të ndërtesave**

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor miraton Metodologji Kombëtare të Kalkulimit (MKK), të përcaktuar me akte nënligjore, e cila:

1.1. përdoret për të kalkuluar energjinë vjetore të nevojshme për të plotësuar kërkesat e ndryshme të një ndërtese lidhur me përdorimin e zakonshëm të saj;

1.2. prodhon një indikator të performancës së energjisë (IPE), i cili pasqyron performancën e kalkuluar kundrejt vlerës së miratuar referente dhe një indikator numerik të energjisë primare në mënyrë që të shprehë performancën në mënyrë transparente;

1.3. përdoret për të kalkuluar nivelet me kosto optimale të kërkesave për performancën energjetike të ndërtesave, njësi të ndërtesave dhe elemente të ndërtesave;

1.4. përdoret për të mbështetur nxjerrjen e Certifikatave të Performancës së Energjisë (CPE-ve);

1.5. merr parasysh të gjitha standardet relevante Evropiane.

2. Metodologjia Kombëtare e Kalkulimit merr parasysh së paku:

2.1. kushtet e brendshme klimatike;

2.2. ngarkesat e brendshme të ndërtesës;

2.3. përçueshmërinë termike dhe kapacitetin termik të strukturave ndarëse, duke përfshirë urat termike;

2.4. sistemet e ngrohjes;

2.5. sistemet për furnizim me ujë të ngrohtë sanitar;

2.6. sistemet për klimatizim të ajrit;

2.7. sistemet e ventilimit dhe infiltrimit të ajrit;

2.8. sistemet e instaluara të ndriçimit;

2.9. pozitën gjeografike dhe orientimin, ndikimi i diellit, si dhe kushtet e jashtme klimatike;

2.10. ndikimin e projektimit të masave pasive të ndërtimit, sikurse ventilimi natyror dhe ndriçimi gjatë ditës;

2.11. sistemet e energjisë nga burimet e ripërtritshme.

3. Metodologjia Kombëtare e Kalkulimit i mbulon, së paku, kategoritë vijuese të ndërtesave kur vlerësohet performanca energjetike për:

3.1. shtëpitë individuale të tipeve të ndryshme;

3.2. ndërtesat e banimit me shume njësi;

3.3. zyrat dhe ndërtesat administrative;

3.4. ndërtesat për edukim;

3.5. spitalet dhe qendrat e kujdesit mjekësor;

3.6. hotelet dhe restorantet;

3.7. ndërtesat e shërbimeve publike qendrore dhe lokale;

3.8. objektet sportive;

3.9. ndërtesat për shërbime tregtare, shitje me shumicë dhe pakicë;

3.10. llojet tjera të ndërtesave që konsumojnë energji.

## **Neni 6**

### **Kërkesat minimale të performancës energjetike**

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerr akt nënligjor për kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave, të bazuar në Metodologjinë Kombëtare të Kalkulimit të cilat:

1.1.aplikohen për performancën energjetike e të gjitha ndërtesave të reja dhe njërive të reja të ndërtesave në ndërtim;

1.2.aplikohen për performancën energjetike të ndërtesave dhe njërive të ndërtesave që do të rinovohen apo rindërtohen (në përputhje me paragrafët 7 dhe 8 të këtij Neni);

1.3.përcaktohen në mënyrë që të arrihen nivelet e kostos optimale, siç është përcaktuar përmes aktit nënligjor;

1.4.aplikohen veçanërisht për kategori të ndryshme të ndërtesave.

2. Këto kërkesa inkorporohen kur hynë në fuqi Kodi Unik i Ndërtimit i Republikës së Kosovës.

3. Nivel me kosto optimale do të thotë niveli i performancës energjetike i cili çon në koston më të ulët gjatë ciklit të vlerësuar jetësor ekonomik, me ç ‘rast:

3.1. kostoja më e ulët përcaktohet duke marrë parasysh kostot e investimeve lidhur me ndërtimin, rindërtimin apo rinovimin, mirëmbajtjen dhe kostot operative (duke përfshirë koston e energjisë dhe kursimet, kategorinë e ndërtesës në fjalë, fitimet nga energjia e prodhuar), kostot e rrënimit-deponimit, kur është e zbatueshme;

3.2. cikli i vlerësuar jetësor ekonomik, përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga MMPH. Kjo i referohet ciklit të vlerësuar jetësor ekonomik të mbetur të ndërtesës ku kërkesat për performancë energjetike janë të vendosura për ndërtesën si tërësi, ose për vlerësimin jetësor ekonomik të një elementi të ndërtesës kur kërkesat për performancë energjetike janë të përcaktuara për elementet e ndërtesës; dhe

3.3. niveli i kostos optimale të jetë brenda vlerave të performancës ku raporti i kost-benefitit është pozitiv i llogaritur si pjesë e analizave të kost-benefitit gjatë vlerësimit të ciklit jetësor ekonomik.

4. Kërkesat minimale për performancën energjetike të elementeve të ndërtesës që përbëjnë pjesën e mbështjellësit të ndërtesës dhe kanë ndikim dukshëm në performancën energjetike kur zëvendësohen apo rinovohen do të përcaktohen me akt nënligjor.

5. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerr akt nënligjore për kërkesat e sistemit në lidhje me performancën e përgjithshme energjetike, instalimin e duhur dhe dimensionimin adekuat, përshtatjen dhe kontrollin e sistemeve teknike të ndërtesës në ndërtesat ekzistuese. Kërkesat e sistemeve teknike të ndërtesave përcaktohen për sistemet të reja, për ato që zëvendësohen dhe modernizohen dhe zbatohen për atë që ato janë të arsyeshme nga aspekti teknik ekonomik dhe funksional.
6. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor inkurajon instalimin e sistemeve inteligjente të matjes kur një ndërtesë është duke u ndërtuar apo i është nënshtruar një rinovimi të madh, dhe mundet, kur është e përshtatshme, të inkurajojë instalimin e sistemeve aktive të kontrollit që synojnë të kursejnë energji.
7. Kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave, njësitë të ndërtesave dhe mbështjellësit të ndërtesave që rinovohen apo rindërtohen, do të zbatohen vetëm nëse dokumentacioni i aplikimit për projektin e ndërtimit ku parashihet rindërtimin e më shumë se 25 % të sipërfaqes së mbështjellësit të ndërtesës.
8. Kërkesat minimale për performancën energjetike për ndërtesat e rindërtuara apo të rinovuara dhe njësitë e ndërtesës nuk zbatohen vetëm nëse aplikimi i këtyre kërkesave nuk është i arsyeshëm nga aspekti teknik apo operacional dhe nuk është ekonomikisht i justifikuar për jetëgjatësinë e ndërtesës.
9. Kërkesat minimale për performancën energjetike për ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave do të rishikohen në intervale të rregullta që nuk do të jenë më të gjata se pesë(5) vite dhe, nëse është e nevojshme, do të azhurnohen në mënyrë që të pasqyrojnë zhvillimin teknik në sektorin e ndërtimit.
10. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji të gjitha ndërtesat e reja me përjashtim të atyre të renditura në Nenin 4 janë të detyruara të përmbushin kërkesat përkatëse minimale për performancën energjetike.
11. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji të gjitha ndërtesat që janë duke bërë rinovim të madh me përjashtim të atyre të renditura në Nenin 4 dhe Nenin 6 paragrafët 7 dhe 8 janë të detyruara të përmbushin kërkesat përkatëse minimale për performancën energjetike.
12. Komunitetet mbështesin projektet e ndërtimit që demonstrojnë përdorimin e sistemeve alternative mbi kërkesat minimale. Mbështetja komunale përfshin përshtatjen e procedurave të marrjes së lejes së ndërtimit dhe zvogëlimin e shpenzimeve për marrjen e këtyre lejeve.

## **Neni 7**

### **Përdorimi i sistemeve alternative me efikasitet të lartë**

1. Kur projektohet një ndërtesë e re apo kur një ndërtesë i nënshtrohet një rinovimi të madh, duhet të vlerësohet mundësia e përdorimit të sistemeve me performancë të lartë si në vijim:

- 1.1. sisteme të decentralizuara për furnizim me energji që përdorin burime të ripërtitëshme;



1.2. sisteme që përdorin kogjenerimin, prodhim e kombinuar te energjisë termike dhe elektrike apo mekanike;

1.3. sisteme që përdorin pompa të nxehtësisë;

1.4. sisteme të ngrohjes dhe ftohjes në largësi apo të bllokut, veçanërisht kur përdoren burime të ripërtërishme të energjisë dhe, të cilat, duke u furnizuar me energji nga një burim qendror i energjisë përdoren për një numër ndërtesash apo zonash.

2. Kur vlerësohet përdorimi i një sistemi alternativ me efikasitet të lartë, merren parasysh aspektet teknike, mjedisore dhe ato ekonomike. Në rast se nevoja për ngrohje është dukshëm me e vogël për ta bërë një apo më shumë nga këto mundësi alternative ekonomikisht të qëndrueshme, kjo duhet të theksohet.

3. Dëshmia për vlerësimin e këtyre masave alternative duhet të përfshihet me dokumentet e ndërtimit të dorëzuara për aplikim për leje ndërtimi.

## **KAPITULLI III**

### **NDËRTESTAT ME KONSUM AFËR ZERO-ENERGJI**

#### **Neni 8**

#### **Ndërtesat me konsum afër zero-energji**

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në koordinim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, harton planin kombëtar për rritjen e numrit të ndërtesave me konsum afër zero-energji. Ky plan përcakton:

1.1. përkufizimin e detajuar për ndërtesat me konsum afër zero-energji, në rrethanat e Kosovës, me referencë tek një indikator numerik për energjinë primare të shfrytëzuar (në kWh/m<sup>2</sup> për vit);

1.2. datën e synuar kur ndërtesat e reja do të përmbushin këtë përkufizim;

1.3.datën e synuar kur ndërtesat e banuara dhe në pronësi të shërbimeve publike do të përmbushin këtë përkufizim;

1.4.objektivat të ndërmjetme për përmirësimin e performancës së ndërtesave të reja;

1.5.objektiva të ndryshme varësisht nga kategoria e ndërtesës;

1.6.informacione mbi politikat dhe masat shtesë të nevojshme për t'i arritur këto objektiva.

2. Plani dorëzohet në Sekretariatit të Energjisë si pjesë e Planit kombëtar të veprimit për efikasitetin e energjisë në të cilën është përfshirë edhe raporti i progresit për zbatimin e këtij plani çdo tri (3) vite.

## **KAPITULLI IV CERTIFIKIMI I PER FORMANCËS ENERGJETIKE**

### **Neni 9**

#### **Certifikimi i performancës energjetike të ndërtesës**

1. Certifikimi i performancës energjetike në ndërtesa është i detyrueshëm për:

- 1.1. ndërtesat që shiten apo jepen me qira;
- 1.2. pjesë të ndërtesave që shiten apo jepen me qira vetëm nëse pjesa e ndërtesës ka një matës të veçantë të ngrohjes;
- 1.3. ndërtesat ekzistuese që shiten apo jepen me qira, nëse certifikimi i performancës energjetike kërkohet nga një qiramarrës apo pronar i mundshëm;
- 1.4. kur ndërtesa ndërtohet, rinovohet apo rindërtohet;
- 1.5. Certifikata e Performancës Energjetike (CPE) është e vlefshme për një periudhë prej dhjetë (10) vitesh që nga momenti i lëshimit apo deri kur ndodhë rrënimi, renovimi apo rikonstruktimi.

2. Për një ndërtesë, sipërfaqja e përdorshme e së cilës tejkalon  $500 \text{ m}^2$ , e cila përdoret nga një autoritet publik e cila vizitohet nga publiku, CPE duhet të ekspozohet në një vend të dukshëm që shihet lehtë nga publiku.

3. Procedura e saktë për certifikimin e performancës energjetike të ndërtesave përcaktohet me akt nënligjor të hartuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

### **Neni 10**

#### **Të dhënat që duhet të përfshihen në certifikatat e performancës energjetike (CPE) dhe kushtet e certifikatës**

1. Certifikata e performancës energjetike (CPE) për ndërtesë duhet të përfshijë:

- 1.1. llogaritjen e performancës së integruar të energjisë së ndërtesës;
- 1.2. indikatorin e llogaritur të performancës energjetike (IPE) për ndërtesën;
- 1.3. indikatorin numerik të energjisë primare për ndërtesën;
- 1.4. karakteristikat e përgjithshme të ndërtesës, duke përfshirë vjetërsinë;
- 1.5. informacion mbi ekspertin e pavarur i cili ka përgatitur certifikatën energjetike të ndërtesës dhe organin që e ka lëshuar atë;
- 1.6. vlerat referente;

- 1.7. rekomandime për përmirësimet me kosto optimale apo kosto efektive të:
    - 1.7.1. sistemeve teknike;
    - 1.7.2. elementeve të ndërtesës; dhe
    - 1.7.3. treguesi se ku mund të gjendet informacion më i detajuar.
  - 1.8. informacion mbi hapat që duhet të ndërmerren për të zbatuar rekomandimet;
  - 1.9. referencën MKK dhe versionin e softuerit të miratuar;
  - 1.10. datën e lëshimit dhe kodin e regjistrimit.
2. Certifikata e Performancës Energjetike të ndërtesës lëshohet nga eksperti i pavarur i certifikuar.
  3. Procedurat me të cilat bëhet certifikimi energjetik i ndërtesave, duke përfshirë procedurat për lëshimin dhe regjistrimin e certifikatës së performancës energjetike të ndërtesës relevante, si dhe llojin, mostrën dhe përmbajtjen e certifikatës së performancës energjetike përcaktohet me akt nënligjor të përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

## **KAPITULLI V INSPEKTIMI**

### **Neni 11**

#### **Inspektimi i sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji nga pronarët e ndërtesave kërkohet që të porosisin inspektime në intervale të rregullta mbi:
  - 1.1. të gjitha sistemet me kalidaja me një prodhim efektiv nominal për ngrohje më të lartë se 100kW;
  - 1.2. të gjitha sistemet e kondicionimit të ajrit me një prodhim efektiv nominal më të lartë se 12 kW.
2. Inspektimi mbulon të gjitha pjesët e qasshme të sistemit, duke përfshirë, sistemet e ngrohjes, gjeneratorin e nxehtësisë, sistemin e kontrollit dhe pompën(at) e qarkullimit.
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerr akt nënligjor për procedurat e inspektimit.
4. Për të gjitha inspektimet, hartohet një raport nga eksperti i pavarur. Raporti i inspektimit përfshinë vlerësimin e efijencës së sistemit dhe dimensionimin në krahasim me kërkesat për ngrohje apo ftohje të ndërtesës. Raporti i inspektimit përmban disa rekomandime që

përmirësojnë performancën energjetike të sistemit, nëse ato janë me kosto efektive në aspektin e jetëgjatësisë së planifikuar të ndërtesës. Raporti mund të përmbajë edhe një krahasim të performancës energjetike të sistemit krahasuar me sistemin e realizueshëm më të mirë në dispozicion, dhe me një sistem ekuivalent që është në përputhje me të gjitha rregulloret aktuale relevante. Ky raport duhet t'i dorëzohet pronarit apo qiramarrësit të ndërtesës dhe institucionit relevant, si dhe duhet të referohet në çdo certifikatë të performancës energjetike nëse ndërtesa i nënshtrohet certifikimit energjetik.

5. Procedurat për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit specifikohen me akt nënligjor të përgatitur nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këto gjithashtu përfshijnë periudhën në mes të inspektimeve, e cila mund të ndryshojë varësisht nga lloji dhe rezultati i përlllogaritur efektiv i sistemit gjersa merret parasysh kostoja e inspektimit të sistemit dhe kursimet e përlllogaritura të energjisë që mund të rezultojnë nga inspektimi. Periudha mund të zgjatet, apo procedura e inspektimit mund të lehtësohet, sipas rastit, kur është i vendosur një sistem elektronik i monitorimit dhe kontrollit.

6. Si alternativë për inspektimet e sistemeve të ngrohjes me kaldaja nën 100 kW, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor zbaton masa alternative që të sigurojë ofrimin e këshillave për përdoruesit sa i përket zëvendësimit të sistemit të kalldave, modifikimeve tjera të sistemeve të ngrohjes, dhe zgjidhjeve tjera alternative për të vlerësuar eficiencën dhe madhësinë e duhur të kalldave.

7. Në çdo tri(3) vite përgatitet raporti për Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë i cili:

7.1. tregon që ndikimi i përgjithshëm i kursimit energjetik dhe i masave alternative është ekuivalent apo më i lartë se inspektimet;

7.2. përfshinë dëshmi kuantitative apo projeksione si prova mbështetëse.

8. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të kërkojë informacion tjetër specifik lidhur me kërkesat dhe ekuivalencën e masave alternative në të cilin rast kjo do të prezantohet, apo ndryshimet e propozuara do të prezantohen brenda nëntë (9) muajve.

9. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në koordinim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik nxjerr akt nënligjor që përcakton specifikimin e detajuar të gjitha elementeve të procedurave të inspektimit.

## **KAPITULLI VI EKSPERTËT DHE SISTEMET E KONTROLLIT**

### **Neni 12 Ekspertët e pavarur**

1. Certifikimi energjetik i ndërtesave dhe inspektimi i sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit zbatohet në mënyrë të pavarur nga një person i kualifikuar dhe i akredituar me ekspertizën e duhur, që vepron ose në kapacitetin e të vetëpunësuarit apo i punësuar nga organet private ose ndërmarrjet private.

2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik përcakton kualifikimet, procesin e certifikimit nga organi i akredituar dhe procedurat e operimit që duhet të ndjekin ekspertët e tillë.
3. Gjatë kryerjes së certifikimit energjetik të ndërtesave apo inspektimit të sistemeve të ngrohjes dhe trajtimit të ajrit, një ekspert i pavarur i akredituar duhet:
  - 3.1. të përdorë metodat e aprovuara dhe standarde të aplikueshme;
  - 3.2. t'i përmbahet MKK-së sipas Nenit 5 të këtij ligji për përgatitjen e CPE-ve;
  - 3.3. të kryejë llogaritjet e nevojshme duke përdorur kontroll të duhur të kualitetit të të dhënave, për t'u siguruar që rezultatet e kalkulimeve janë të sakta, objektive dhe të besueshme;
  - 3.4. t'i përmbahet kodit të praktikës dhe procedurave të AKEE-së;
  - 3.5. të sigurohet që të dhënat e certifikimit energjetik dhe të verifikimit të ruhen se paku njëmbëdhjetë (11) vite.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik nxjerr akt nënligjor i cili menaxhohet nga Agjencia e Kosovës për Efiçencën e Energjisë i cili përcakton: a) kërkesat për ekspertizë dhe kompetencë të një eksperti të pavarur për certifikim dhe procedurat e inspektimit, b) kualifikimet, procesin e akreditimit dhe procedurat e operimit, c) procedurat e mbikëqyrjes, d) kërkesat për trajnime, e) kodin e praktikës dhe procedurat e operimit.
5. Lista e ekspertëve të kualifikuar dhe të akredituar duhet të jetë në dispozicion publik përmes një regjistri kombëtar të menaxhuar nga Agjencia e Kosovës për Efiçencën e Energjisë.

### **Neni 13**

#### **Sistemi i pavarur i kontrollit**

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik nxjerr aktet nënligjore për sistemin e pavarur të kontrollit që menaxhohet nga Agjencia e Kosovës për Efiçencën e Energjisë.
2. Qëllimi i këtij sistemi të kontrollit është të verifikoj CPE-të nga një kombinim që do të përcaktohet me akt nënligjor si në vijim:
  - 2.1. kontrolli mbi vlefshmërinë e të dhënave të futura të ndërtesës të përdorura për lëshimin e certifikatës së performancës energjetike, si dhe konfirmimi që rezultatet e paraqitura në certifikatë janë në formatin e duhur;
  - 2.2. sikurse nen-paragrafi 2.1 më lartë, si dhe verifikimet shtesë të saktësisë së rezultateve të llogaritura dhe të rekomandimeve të bëra;
  - 2.3. sikurse nen-paragrafi 2.2. më lartë, si dhe vizita në teren të ndërtesës për të kontrolluar korrespondimin në mes specifikacioneve të ofruara në certifikatën e performancës energjetike dhe ndërtesës së certifikuar.

3. Autoritetet kompetente bëjnë përzgjedhje të rastit të së paku një përqindje të statistikave të raporteve inspektuese të lëshuara çdo vit, të cilat i nënshtrohen verifikimit.
4. CPE-të dhe raportet e inspektimit duhet të vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente sipas kërkesës.
5. Agjencia e Kosovës për Efiçencën e Energjisë harton regjistrin kombëtar për ruajtjen e CPE-ve dhe sipas nevojës edhe raportet e inspektimit, që lejon qasje të kufizuar të publikut për të kontrolluar vlefshmërinë e CPE-ve.

## **KAPITULLI VII DETYRIMET E PRONARIT TË NDËRTESESË**

### **Neni 14 Detyrimet e pronarit të ndërtesës**

1. Pronari i ndërtesës, në rastet e përcaktuara me këtë Ligj:

1.1. është i obliguar që të zbatojë certifikimin energjetik të ndërtesës siç kërkohet në Nenin 9 për të gjithë ndërtesën, ose për njësitë e ndërtesës si pjesë të saj;

1.2. është i obliguar që të porosisë inspektime të rregullta të sistemeve të ngrohjes dhe/ose të kondicionimit të ajrit sipas rastit;

1.3. duhet të sigurohet që ndërtesa pas një rinovimi të madh është në përputhje me kërkesat minimale për performancë energjetike sa i përket ndërtesës, njësive dhe elementeve të ndërtesës;

1.4. duhet të sigurohet, që nëse ndërtesa është në pronësi nga qeveria qendrore apo lokale, vendosja e certifikatës energjetike të ndërtesës të bëhet në një vend të dukshëm;

1.5. ndërtesa, njësitë e ndërtesës apo pjesë të saj, të cilat vendosen për shitje apo qiradhënie, duhet të reklamohen klasën e CPE-se dhe t'ju ofrojnë CPE-në e plotë dhe raportet e inspektimit (nëse janë zbatuar) blerësve apo qiramarrësve potencialë, nëse sipas këtij Ligji ndërtesa duhet të ishte certifikuar;

1.6. siguron sistemet e reja, të zëvendësuara apo të përmirësuara teknike në ndërtesat ekzistuese që të jenë në pajtim me kërkesat e sistemit të paraparë sipas nenit 6 të këtij ligji.

## **KAPITULLI VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 15 Detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve**

1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për mbikëqyrjen e përgjithshme, bashkërendimin dhe masat zbatuese për performancën energjetike të ndërtesave.
2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Agjencia e Kosovës për eficiencyn e energjisë janë përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për eficiencyn energjetike në ndërtesa.
3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, e mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Agjencia e Kosovës për Eficiencyn e Energjisë.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për themelimin e sistemeve të nevojshme për mbikëqyrjen e inspektimit mbi certifikimet energjetike dhe inspektimet e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit.
5. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për certifikimin dhe përcaktimin e kërkesave për trajnim të Ekspertëve të pavarur.
6. Ministria e Zhvillimit Ekonomik është përgjegjëse për miratimin e kodit të praktikës dhe procedurave për Agjencinë e Kosovës për Eficiencyn e Energjisë.
7. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për ofrimin e informacionit për publikun lidhur me metodat dhe praktikatat e ndryshme për përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave.
8. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e mbështetur nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, është përgjegjëse për promovimin e rinovimit të ndërtesave dhe zhvillimin e ndërtesave me energji të ulët apo pothuajse zero.
9. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për mirëmbajtjen e sistemeve të informimit të nevojshme për marrjen e të dhënave të nevojshme për certifikimin energjetik të ndërtesave dhe inspektimet e pavarura.
10. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për sigurimin se banorët e ndërtesave dhe përdoruesve u ofrohen sugjerime për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit si dhe për përmirësimin e përgjithshëm të performancës energjetike të ndërtesave.
11. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për Kodin e Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës i cili përcakton kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave, njësive të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave.

12. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për Kodin e Unik të Ndërtimit të Republikës së Kosovës i cili përcakton kërkesat minimale të sistemit për sistemet teknike të ndërtesave në ndërtesat ekzistuese.

**Neni 16**  
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1.Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, institucionet përgjegjëse dhe kompetente nxjerrin aktet nënligjore në afat prej tetëmbëdhjetë (18) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 17**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-101**  
**1 dhjetor 2016**

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

\_\_\_\_\_  
**Kadri VESELI**